



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Ministri i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,

Në mbështetje të nenit 19 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-237, për Kadastër të Pronës së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2/09 Janar 2024), nenit 11, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr.34/22 dt. 18.11.2022), si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr.15, 12.09.2011),

Nxjerr:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MMPHI) NR.09/2024 PËR PËRMBAJTJEN DHE
PROCEDURAT E NDARJES DHE BASHKIMIT TË ZONAVE KADASTRALE**

Neni 1
Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të përcaktojë përmbajtjen dhe procedurat e krijimit përmes ndarjes, bashkimit si dhe ri rregullimit të kufirit të zonave kadastrale.

Neni 2
Fushë veprimi

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen nga Agjencia Kadastrale e Kosovës, zyrat kadastrale komunale, Institucionet tjera publike dhe personat që ushtrojnë autorizime publike.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këtë kuptim:

1.1. **ZK** –Zona Kadastrale.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin e njëjtë me shprehjet e përdorura në Ligjin Nr.08/L-237 për Kadastër të Pronës së Paluajtshme.

3. Në kuptim të këtij Udhëzimi Administrativ emrat në gjininë mashkullore nënkuptojnë edhe emrat në gjininë femërore dhe anasjelltas, pa diskriminim.

Neni 4 Zonat Kadastrale

1. Komunat në Republikën e Kosovës janë të ndara në zona kadastrale.

2. Çdo ZK ka kufirin e vetë, i cili krijohet nga kufiri i parcelave kadastrale që gjenden në ZK-në, në pjesën që kufizohet me ZK-të fqinje.

3. Çdo ZK në Republikën e Kosovës e ka një numër kadastral unik.

Neni 5 Mirëmbajtja e kufirit të ZK

Mirëmbajtja e kufirit të ZK bëhet nga AKK-ja.

Neni 6 Regjistrimi i ZK në regjistrin kadastral

1. Emërtimi , kufiri, numri unik dhe të dhënat për njësitë kadastrale janë të regjistruara në regjistrin kadastral.

2. Caktimi dhe ndryshimi i numrit unik të ZK-së bëhet me vendim nga AKK-ja.

Neni 7 Ndarja, bashkimi dhe ri-rregullimi i kufirit të ZK

1. Krijimi i një zonë kadastrale bëhet nga:

1.1. Ndarja apo

1.2. Bashkimi

2. Kur një ZK përbëhet nga dy e më shumë vendbanime, mund të krijohet ZK për secilin vendbanim, me arsyetim për nevojën e krijimit të zonës së re kadastrale.

3. Propozimet për formimin, ndryshimin apo shuarjen e ZK-së paraqiten dhe arsyetohen nga institucionet përkatëse apo banorët e ZK-së në kuvendin e komunës ose në institucionet tjera të autorizuara me legjislacionin në fuqi.

4. Vendimin për regjistrimin e krijimit, ndryshimit apo shuarjes së ZK-së e merr AKK-ja pas pranimit të kërkesës dhe vendimit nga kuvendi komunal ose institucionet tjera të autorizuara me legjislacionin në fuqi, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.

5. Kundër vendimit të AKK-së nga paragrafi 3 i këtij neni, mund të paraqitet ankesë nga palët që kanë interes në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur u është dorëzuar vendimi. Ankesa paraqitet përmes AKK-së në Komisionin për shqyrtimin e ankesa në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Neni 8 **Emërtimi i ZK-së**

Emërtimi i ZK-së bëhet me vendim të organeve dhe të institucioneve të tjera kompetente në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 9 **Ndryshimi i kufirit të ZK-ve**

1. Kur me vendim të organit kompetent bëhet ndryshimi i kufirit të komunave, regjistrimin e tyre në regjistrin kadastral e bën AKK-ja.

2. Në rastet kur bëhet korrigjimi i kufirit të dy parcelave që janë në zona kadastrale fqinje, ndryshohet edhe kufiri i zonës kadastrale.

3. Ndryshimi i kufirit të ZK-së dhe të komunës që është si rezultat i kryerjes së rregullimit të tokave bujqësore bëhet në bazë të vendimit të komisionit për rregullimin e tokave bujqësore.

Neni 10 **Regjistri i ZK-ve**

AKK-ja është e obliguar të mbajë regjistrin e ZK-ve të Republikës së Kosovës me të gjitha të dhënat e domosdoshme siç janë: emërtimi, kufiri, numri kadastral unik, sipërfaqja, numri i njësive kadastrale dhe numri i pronarëve.

Neni 11 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ Nr. 09/2019 për Ndarjen e Zonave Kadastrale.

Neni 12 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Liburn ALIU

Ministër i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Datë:07.05.2024

Prishtinë